

## MEMORANDUM MIREKUPTIMI

### NDËRMJET

#### TEATRIT KOMBËTAR TË OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR TË MINISTRISË SË KULTURËS SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

### DHE

#### QENDRËS KOMBËTARE KULTURORE "OPERA E KAIROS" TË MINISTRISË SË KULTURËS SË REPUBLIKËS ARABE TË EGJIPTIT

Teatri Kombëtar i Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor i Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Qendra Kombëtare e Kulturës "Opera e Kairos" e Ministrisë së Kulturës së Republikës Arabe të Egjiptit (në tekstin e mëtejme referuar si "Palët");

Duke marrë parasysh dëshirën për të promovuar bashkëpunimin e ndërsjelltë;

Duke besuar se një bashkëpunim i tillë do të kontribuojë në forcimin përbashkët të ndërgjegjësimit, respektit, mirëkuptimit dhe miqësisë reciproke ndërmjet dy vendeve;

Të nxitur nga dëshira për të zgjeruar dhe përmirësuar bashkëpunimin artistik, bazuar në interesin e përbashkët dhe me besim të plotë që ky Memorandum Mirëkuptimi do të krijojë mundësitë më të mira për bashkëpunim kulturor dhe do të mundësojë një shkëmbim të kënaqshëm kulturor ndërmjet dy vendeve;

Kanë rënë dakord si më poshtë:

### OBJEKTI

#### Neni 1

Njohjen e ndërsjelltë të kulturave respektive dhe inkurajimin e nismave që inkurajojnë bashkëpunimin kulturor dhe artistik ndërmjet tyre përmes shkëmbimit kulturor.

Forcimi dhe krijimi i kushteve për realizimin e shfaqjeve të përbashkëta të Teatrit Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor të Republikës së Shqipërisë në skenat e Qendrës Kombëtare të Kulturës të "Operas së Kairos" në Egjipt, dhe anasjelltas.

## **FUSHAT E BASHKËPUNIMIT**

### **Neni 2**

Palët do të inkurajojnë pjesëmarrjen e përfaqësuesve të tyre në festivalet ndërkombëtare, evente artistike dhe evente të tjera kulturore, të cilat zhvillohen në të dy vendet.

(Secila Palë do të informojë Palën tjetër për kushtet e pjesëmarrjes, programet e dhe datat e këtyre eventeve kulturore.)

### **Neni 3**

Palët do të inkurajojnë shkëmbimin midis teatrove, baletit dhe grupeve të vallëzimit modern dhe bashkëkohor, arteve pamore, dizajnin, kërcimin dhe të të gjitha grupeve të tjera artistike, artistëve, kërcimtarëve, koreografëve, ekspertëve të kërcimit dhe mësuesve, si dhe do të inkurajojnë pjesëmarrjen e tyre në turne, festivale, dhe evente kulturore të organizuara nga pala tjetër, duke përfshirë konferenca, seminare, shfaqje të përbashkëta, takime pune, ekspozita arti dhe takime që kërkojnë shkëmbimin e njohurive dhe përvojave.

### **Neni 4**

Palët do të inkurajojnë prezantimin e punës së kompozitorëve të tyre në vendin tjetër, si dhe shkëmbimin e orkestrave dhe muzikantëve (dirigjentë, solistë, etj.) në fushën e muzikës klasike dhe bashkëkohore Arabe.

### **Neni 5**

Palët do të inkurajojnë projekte të përbashkëta që do të përmirësojnë menaxhimin e teatrove, ekspertizën kuratoriale, strategjitë e marketingut, komunikimin, marrëdhëniet me median, arsimin dhe audiencën.

### **Neni 6**

Palët do të përpiqen të promovojnë ndërtimin e kapaciteteve duke lehtësuar trajnimin dhe shkëmbimin e kontakteve ndërmjet profesionistëve dhe praktikuesve të tjerë të muzeve nga të dy vendet.

## **Kuadri Ligjor**

### **Neni 7**

Ky Memorandum Mirëkuptimi shpreh vetëm qëllimin e përbashkët për bashkëpunim dhe nuk detyron detyrime financiare, angazhime personeli, shërbime ose burimeve shtesë sipas ligjit ndërkombëtar dhe kuadrit ligjor të brendshëm të secilës Palë.

### **Neni 8**

Aktivitetet bashkëpunuese të ndërmarra në përputhje me këtë Memorandum Mirëkuptimi i nënshtrohen ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në të dy vendet dhe marrëveshjes së të dy qeverive përpara fillimit të çdo aktiviteti.

#### **Neni 9**

Secila Palë vepron në mënyrë të pavarur në përputhje me zhvillimin e aktiviteteve sipas Memorandumit nuk tregon se ai/ajo është një punonjës ose agjent i Palës tjetër.

#### **Neni 10**

Ky Memorandum Mirëkuptimi nuk i jep një pale të tretë asnjë përfitim, si të drejta ligjore ose të barabarta, pretendime ose të drejta juridike.

#### **Neni 11**

Shkëmbimi i informacionit konfidencial ose personal nuk parashikohet në këtë marrëveshje.

#### **Neni 12**

Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi ose zbatimi i këtij Memorandumi Mirëkuptimi do të zgjidhet në mënyrë miqësore përmes konsultimeve në rrugë diplomatike.

### **DISPOZITAT FINANCIARE**

#### **Neni 13**

Shkëmbimi i individëve dhe grupeve:

Pala dërguese do të mbulojë shpenzimet e udhëtimit ndërkombëtar.

Pala pritëse do të mbulojë shpenzimet e akomodimit të plotë dhe transportit lokal sipas programit të vizitës (periudha e qëndrimit), me kusht që të përjashtohen telefonatat ndërkombëtare, pijet alkoolike dhe lavanderia.

#### **Neni 14**

Aktivitetet bashkëpunuese të ndërmarra në bazë të këtij Memorandumi Mirëkuptimi do të jenë subjekt i disponueshmërisë së fondeve dhe burimeve të Palëve.



## Neni 15

Çdo çështje e mëtejshme financiare dhe organizative sipas dispozitave të këtij Memorandumi Mirëkuptimi do të dakordësohet përmes kanaleve diplomatike.

## Neni 16

Ky Memorandum Mirëkuptimi mund të ndryshohet me pëlqimin me shkrim ndërmjet të dy Palëve, nëpërmjet kanaleve diplomatike, dhe me të njëjtat procedura që ky Memorandum Mirëkuptimi ka hyrë në fuqi.

Ky Memorandum Mirëkuptimi do të hyjë në fuqi nga momenti i nënshkrimit të tij dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë katër (4) vjeçare dhe mund të rinovohet për periudha të ngjashme me pëlqimin me shkrim ndërmjet dy Palëve. Përveç nëse çdo Palë mund të tërhiqet nga Memorandumi duke njoftuar Palën tjetër me shkrim, jo më vonë se gjashtë muaj përpara datës së tërheqjes.

Përfunduar në *Tiranë* më *19.09* 2022 në dy (2) kopje origjinale secila në shqip, arabisht, dhe anglisht, ku të gjitha tekstet janë njëllëj autentike. Në rast mospërputhje në interpretim, teksti në anglisht do të ketë përparësi.


Për Ministrinë e Kulturës së

Republikës së Shqipërisë



Për Ministrinë e Kulturës së

Republikës Arabe të Egjiptit



**MEMORANDUM OF UNDERSTANDING**

**BETWEEN**

**THE NATIONAL THEATER OF OPERA, BALLET AND FOLK ENSEMBLE OF THE  
MINISTRY OF CULTURE OF THE REPUBLIC OF ALBANIA**

**AND**

**THE NATIONAL CULTURAL CENTER "CAIRO OPERA HOUSE" OF THE  
MINISTRY OF CULTURE OF THE ARAB REPUBLIC OF EGYPT**

The National Theater of Opera, Ballet and Folk Ensemble of the Ministry of Culture of the Republic of Albania and the National Cultural Center "Cairo Opera House" of the Ministry of Culture of the Arab Republic of Egypt (hereinafter referred to as the "Parties");

Considering the desire to promote mutual cooperation;

Believing that such cooperation will contribute to strengthening mutual awareness, respect, understanding and friendship between both countries;

Urged by the desire to expand and improve artistic cooperation, based on the common interest and with full confidence that this Memorandum of Understanding will create the best opportunities for artistic cooperation and will enable satisfactory cultural exchange between the two countries;

Have reached the following understanding:

**OBJECTIVE**

**Article 1**

Enhancing knowledge of the other's culture and encouraging initiatives aimed at encouraging cultural and artistic cooperation between them in the context of cultural exchange.

Forge and establish the conditions for the joint execution of the performances of the National Theater of Opera, Ballet and Folk Ensemble of the Republic of Albania on the stages of The National Cultural Center "Cairo Opera House" in Egypt, and vice versa.

